



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHITIME
Nr.01-060/01-21266/21 datë:18.08.2021



Npi – 01/227 datë: 27.08.2021

Bazuar në nenet 12.2 pika (d) dhe nenin 17 pika (j) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Në mbështetje të nenit 45 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Shëndetësi Nr.04/L-125; Rregulloren e MAPL Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës; Si dhe duke marrë parasysh kërkesën e Ministrisë të Pushtetit Lokal, Nr. 020-658-9 dt. 5.8.2021 për rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01-149 për Statutin e QKMF-Shtime Kuvendi Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 27.08.2021 aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR KONFIRMIMIN E VENDIMIT Npi-01/149 PËR APROVIMIN E STATUTIT TË QKMF-së “Dr.VEZIR BAJRAMI” NË SHITIME

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VIII- të rregullt për vitin 2021, të mbajtur më 27.08.2021, unanimisht vendosi të konfirmojë, vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-0/149 të datës: 03.06.2021, për aprovimin e Statutit të QKMF-së në Shtime, me emërtimin “Dr.Vezir Bajrami”.

II

Ar s y e t i m: Kuvendi i Komunës së Shtimes, e diskutoi kërkesën e Ministrisë të Pushtetit Lokal, Nr. 020-658-9 dt. 5.8.2021 për rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01-149 për Statutin e QKMF-Shtime, dhe pas sçarimit që bëri Kryesuesja e Kuvendit, duke bërë me dije Kuvendin se tani kemi edhe pëlqimin e Minisatrisë së QKMF-ja në Shtime mundet me e mbajtë emrin “Dr.Vezir Bajrami”, Kuvendi mori vendim si në dispozitiv.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi me Statutin u dërgohet: Arkivit, QKMF-Shtime, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushtetit Lokal, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj